

RAPORT

Mbi monitorimin e zbatimit të parashikimeve ligjore që përcaktojnë funksionet, kompetencat, detyrat dhe rolin e organeve të qeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore dhe masave ndaj dhunës në familje

2022


Ky raport u bë i mundur me mbështetjen financiare të ofruar nga "Bashki të Forta" një projekt i Agjencisë Zviceriane për zhvillim dhe Bashkëpunim (SCD) nën supervizimin e Znj. Valbona Karakaçi, Këshilltare Strategjike e BtF dhe Znj. Arbëresha Mushani Oficere Programi e BtF.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të "Bashki të Forta" dhe të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SCD).

Tiranë, 2022

PËRGATITI:

**ENDIRA BUSHATI
EDLIRA ÇEPANI**



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



PASQYRA E LËNDËS

HYRJE.....	4
I. METODOLOGJIA.....	5
II. DETYRIMET LIGJORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	6
III. TË DHËNAT E PYETËSORIT.....	10
IV. KONKLUZIONE.....	36
V. REKOMANDIME.....	38

HYRJE

Të drejtat e grave janë pjesë e pandarë e të drejtave dhe lirive të njeriut. Detyrimi i organeve të pushtetit publik, qendror dhe vendor, për të respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut është i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kur përcaktohet se këto organe, në përmbushje të detyrave të tyre, jo vetëm duhet t'i respektojnë këto të drejta dhe liri, por dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Në drejtim të arritjes së barazisë gjinore të plotë në vend, Republika e Shqipërisë përveç parashikimeve kushtetuese dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, ka miratuar një sërë ligjesh që synojnë garantimin për respektimin, mbrojtjen dhe fuqizimin e barazisë gjinore në shoqëri.

Në këtë drejtim, roli i organeve të qeverisjes vendore është i pazëvendësueshëm dhe ka ardhur progresivisht duke u rritur edhe në raport me parashikimet e ndryshme strategjike dhe ligjore që përcaktojnë funksionet, kompetencat dhe detyrat e këtyre organeve në fushën e barazisë gjinore dhe masave ndaj dhunës në famije. Tashmë, përmes ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, në zgjedhjet për këshilla bashkiakë, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm duhet t'i përkasin të njëjtës gjini, duke garantuar kështu përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në këshillin bashkiak të çdo bashkie.

Ky raport i shërben këshillit bashkiak për të monitoruar respektimin e barazisë gjinore në bashkinë përkatëse në respekt të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

I. METODOLOGJIA

Për herë të parë në Shqipëri, është zhvilluar Barometri i Barazisë Gjinore, në formën e një pyetësoi, në 61 Bashki të vendit realizuar nga Komisioni i Barazisë Gjinore & Aleanca e Grave Këshilltare Bashkiake dhe plotësuar nga administratat e bashkive përkatëse sipas drejtorive përgjegjëse. Pyetësoi përmban të gjithë dispozitat ligjore që përcaktojnë funksionet dhe kompetencat e bashkive në drejtim të realizimit të barazisë gjinore dhe marrjes së masave për parandalimin dhe përballimin e fenomenit të dhunës në familje.

61 Bashki i janë përgjigjur Pyetësorit në raundin e parë. Më pas në Drejtoritë përkatëse janë kryer takime informuese me përfaqësuese të Aleancës së Grave Këshilltare Bashkiake. Bashkitë kanë patur mundësi të rishohin dhe plotësojnë përgjigjet e tyre edhe në raundin e dytë të pyetësorit i cili është rishikuar në mënyrë specifike për secilën prej bashkive.

Përmes këtij Pyetësoi, është synuar të nxirren rezultate të matshme në bashkitë përkatëse në raport me zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në ligje të posaçme që rregullojnë çështjet e barazisë gjinore dhe masat kundër dhunës familjare. Në këtë kuptim, Pyetësoi përfshin aspekte të ndryshme, që nga çështjet e diskriminimit me bazë gjinore, përfaqësimi në çdo nivel në administratën bashkiake deri në çështjet e shërbimeve social apo të promovimit të ndërmarrjeve sociale në bashki. Përgjigjet e Pyetësorit janë të tilla që nuk lënë vend për interpretime, por evidentojnë qartë nëse bashkia ka realizuar apo jo një detyrim ligjor konkret. Për çdo detyrim ligjor është hartuar një pyetje konkrete, e cila synon, sipas rastit të verifikojë plotësimin e këtij detyrimi nga bashkia apo masën e realizimit të këtij detyrimi. Për çdo pyetje është dhënë referenca ligjore përkatëse.

II. DETYRIMET LIGJORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.

Anketimi është kryer duke pasur parasysh detyrimet ligjore si më poshtë:

II. 1. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

- a) Përfaqësimi gjinor në organet drejtuese të bashkisë**
- b) Përfaqësimi gjinor në njësitë administrative dhe rajonet**
- c) Përfaqësimi gjinor në nivelet e administratës së bashkisë**
- d) Përfaqësimi gjinor në bordet e krijuara nga bashkia**
- e) Statistika vendore me bazë gjinore**
- f) Bashkëpunimi me organizatat në nivel vendor**
- g) Masa konkrete nënligjore, administrative, sociale për gratë, nënat e reja dhe viktimat e dhunës familjare.**

II. 2. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

- a) Masa konkrete për parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore**
- b) Identifikimi dhe ndjekja e rasteve të diskriminimit në njësitë vendore**

II. 3. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

- a) Këshilli bashkiak**
- b) Shpenzimet për politikën gjinore**
- c) Struktura monitoruese mbi treguesit gjinorë në shërbimet publike**
- d) Pjesëmarrja gjinore në skemën e granteve të bujqësisë**
- e) Nëpunësi vendor për barazinë gjinore**
- f) Shërbimet sociale për gratë dhe viktimat e dhunës dhe trafikimit**

II. 4. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”

- a) Burime financiare për arritjen e barazisë gjinore**
- b) Objektivat Gjinorë në Programet buxhetore afatmesme**

II.5. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.9906/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

- b) Nëpunës vendor për dhunën në familje**
- c) Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për dhunën në familje.**
- d) Bashkëpunimi mes njësive vendore për rastet e dhunës**
- e) Kërkesa për urdhër mbrojtje nga bashkia**

II.6. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”

- a) Informacioni mbi programet sociale të strehimit**
- b) Të dhënat me bazë gjinore mbi përfitueset e programeve sociale të strehimit**
- c) Masat për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve në sistemin parashkollor publik**
- d) Planifikimi në buxhet i fondeve vjetore për strehimin**

II.7. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

- a) Shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkisë për gratë dhe viktimat e dhunës familjare.**
- b) Strehëza për gratë dhe viktimat e dhunës familjare**

II.8. Detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr.65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”

- a) Politika të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale për gratë.**



PËRCAKTIMET LIGJORE - DETYRIM PËR BASHKITË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:

Bashkitë të cilat kanë plotësuar përcaktimet ligjore për organet e qeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Detyrimi për ngritjen e një strukture pranë bashkisë përgjegjëse për matjen e performancës së shërbimit në aspektin gjinor.

11
BASHKI

Detyrimi për masa konkrete që duhet të marrë bashkia për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.

12
BASHKI

Krijimi i strehëzave si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktima të dhunës familjare.

14
BASHKI

Mbështetja dhe stimulimi i ndërmarrjeve sociale për gratë, gratë në zonat rurale, vajzat viktima të dhunës familjare.

15
BASHKI

Detyrimi për krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural me akses të balancuar gjinor.

19
BASHKI

Dhënia e shërbimit të kujdesit shoqëror për vajzat shtatzëna, prindër të vetëm të një fëmije deri në moshën 1 vjeç dhe viktima të dhunës familjare.

23
BASHKI

Detyrimi për hartimin e dhe vendosjen e një sistemi treguesish për aspektin gjinor për matjen e performancës.

24
BASHKI

Detyrimi për programet e ndryshme të strehimit social për gratë kryefamiljare, vajzat nëna, gratë viktima të dhunës familjare.

38
BASHKI

Detyrimi për planifikimin e fondeve vjetore në buxhet për realizimin e programeve të ndryshme të strehimit.

39
BASHKI

Detyrimi ligjor për të paktën një objektiv të politikave të programeve që adreson pabarazinë gjinore.

42
BASHKI

0 % 10 % 20 % 30 % 40 % 50 % 75% 100%

Detyrimi ligjor për marrjen e masave konkrete për krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare për realizimin e barazisë gjinore.

45
BASHKI

Detyrimi për kuotën 30% për zëvendëskryetarët e bashkisë.

45
BASHKI

Detyrimi për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinive.

46
BASHKI

Detyrimi për informacion të plotë e të kuptueshëm për programet sociale të strehimit për gratë kryefamiljare, vajzat nëna dhe viktimat e dhunës në familje.

47
BASHKI

Detyrimi për bashkëpunim me shoqërinë civile që operon në fushën e barazisë gjinore.

50
BASHKI

Detyrimi për krijimin e shërbimeve sociale për gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikimit, vajzat nëna.

51
BASHKI

Detyrimi për bashkëpunim me njësitë e tjera të qeverisjes vendore për mbrojtjen dhe shërbimet e nevojshme për viktimat e dhunës familjare.

56
BASHKI

Detyrimi për marrjen e masave konkrete për promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore.

57
BASHKI

Detyrimi për emërimin e një nëpunësi vendor për çështjet e barazisë gjinore.

57
BASHKI

Detyrimi për caktimin e strukturës përgjegjëse/koordinatorit vendor për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

58
BASHKI

Detyrimi për ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.

60
BASHKI

Respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurimit në administratën e bashkisë.

60
BASHKI

0% 20% 40% 60% 75% 100%

III. TË DHËNAT E PYETËSORIT


III. A. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1. PËRQINDJA E DETYRIMEVE LIGJORE QË PËRMBUSHIN BASHKITË

Sipas përqindjes së detyrimeve që përmbush secila bashki në BGJ, në bazë të dhënave, në krye qëndron bashkia Tiranë me 83% të detyrimeve ligjore të plotësuara, pasuar nga Vlora, Kamza, Kukësi, Lushnja, Patosi, Divjaka me 79% të këtyre detyrimeve.

Bashkitë me përqindjen më të ulët të detyrimeve ligjore të përmbushura janë: Dropull (17%) Pustec (33%) dhe Tropojë (33%), Skrapar 38%, Libohovë 42 %.

RADHITJA E PËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE LIGJORE NË BASHKITË E SHQIPËRISË



2. NUMRI I BASHKIVE QË PËRMBUSHIN SECILIN PREJ DETYRIMEVE LIGJORE:

Sipas të dhënave të Anketimit, standardet ligjore të paplotësuara në masë të madhe nga bashkitë janë:

- a) Detyrimi për ngritjen e një strukture përgjegjëse pranë bashkisë për matjen e performancës së shërbimeve në aspektin gjinor; (asnjë bashki 0%)
- b) Detyrimi për masa konkrete që duhet të marrë bashkia për punësimin e vajzave nëna dhe sisteminin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor public (11 bashki ose 18 %)
- c) Numri i administratoreve gra të njësive administrative (12 bashki ose 20%);
- d) Krijimi i strehëzave si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktimë e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. (14 bashki ose 23 %);
- e) Marrja e masave të karakterit administrativ dhe social për gratë shtatzëna dhe nënat e reja. (15 bashki ose 25 %).

DETYRIMET LIGJORE MË PAK TË PËRMBUSHURA NË BASHKITË E SHQIPËRISË


a) Detyrimi për ngritjen e një strukture përgjegjëse pranë bashkisë për matjen e performancës së shërbimeve në aspektin gjinor; (asnjë bashki 0%)

b) Detyrimi për masa konkrete që duhet të marrë bashkia për punësimin e vajzave nëna dhe sisteminin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor public (11 bashki ose 18 %)


c) Numri i administratoreve gra të njësive administrative (12 bashki ose 20%);

d) Krijimi i strehëzave si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktimë e dhunës në familje. (14 bashki ose 23 %);

e) Marrja e masave të karakterit administrative dhe social për gratë shtatzëna dhe nënat e reja.(15 bashki ose 25 %).



Dy janë detyrimet ligjore që i kanë përmbushur të gjitha bashkitë:



 a) Detyrimi për ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Dhunës

 b) Respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave të rekrutimit.

3. NUMRI I BASHKIVE QË PLOTËSOJNË DETYRIMET SIPAS LIGJEVE

a) Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 58 bashki.

58 BASHKI

a) Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 57 bashki.

57 BASHKI

a) Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 54 bashki.

54 BASHKI

a) Ligji “Për financat e qeverisjes vendore” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 37 bashki.

37 BASHKI

a) Ligji “Për strehimin social” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 34 bashki.

34 BASHKI

a) Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 25,4 bashki.

25.4 BASHKI

a) Ligji “Për ndërmarrjet sociale në RSH” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 23 bashki.

23 BASHKI

a) Kushtetuta dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 15 bashki.

15
BASHKI

a) Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” dhe detyrimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore plotësohen në mesatare nga 14 bashki.


14
BASHKI

0

25

50

75




III. B. TË DHËNAT E PYETËSORIT SIPAS DETYRIMEVE PËRKATËSE LIGJORE

4. RESPEKTIMI I DETYRIMIT LIGJOR TË PËRFAQËSIMIT GJINOR ME TË PAKTËN 30% NË ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE TË BASHKISË.

- a) 15 Bashki ose 25% nuk plotësojnë detyrimin ligjor prej 30% gra në zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të bashkisë.
- b) Bashkitë Memaliaj, Gramsh, Konispol, Rrogozhinë, Kolonjë dhe Devoll e plotësojnë detyrimin ligjor 100%
- c) Bashkitë Malësi e Madhe dhe Kavajë e plotësojnë 67 %.
- d) 26 bashki e plotësojnë në masën 50%. (Fushë-Arrëz, Gjirokastër, Libohovë, Përmet, Tepelenë, Librazhd, Belsh, Peqin, Bulqizë, Mat, Klos, Dimal, Skrapar, Delvinë, Selenicë, Himarë, Lezhë, Mirditë, Tiranë, Kamzë, Kukës, Has, Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër
- e) Bashkitë Pukë, Shijak, Berat, Vlorë, Sarandë, Tropojë, Divjakë, Korçë, Maliq, Pogradec e plotësojnë në masën 30%.
- f) Bashkia Elbasan dhe Lushnjë e plotësojnë në masën 25 %.
- g) Në kohën e anketimit numri i bashkive me kryetar bashkie grua ka qenë 10 (Shkodër, Durrës, Libohovë, Përmet, Dimal, Delvinë, Kurbin, Lushnjë, Patos, Roskovec.) Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Kurbin nuk kanë asnjë zëvendëskryetare grua, duke pasur raportin 0% të zëvendëskryetarëve në raport me zëvendëskryetarët. Libohovë, Përmet, Dimal, Delvinë, Patos dhe Roskovec e kanë këtë raport 50% (1 zëvendëskryetar grua), ndërsa Lushnja 25% (1 zëvendëskryetare grua/3 burra).

16 BASHKI, OSE 26% NUK PLOTËSOJNË DETYRIMIN LIGJOR PREJ 30% GRA NË ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE TË BASHKISË.



5. RESPEKTIMI I DETYRIMIT LIGJOR TË PËRFAQËSIMIT GJINOR ME TË PAKTËN 30% NË POZICIONIN E ADMINISTRATORËVE:

a) 49 Bashki ose 82% nuk plotësojnë detyrimin ligjor prej 30% gra në pozicionin e administratorëve;

b) Bashkia Sarandë dhe Kurbini renditen në krye me 100 % të detyrimit ligjor të plotësuar; pasuar nga Pukë, Libohovë, Dimal, Konispol dhe Lezhë me 50 %;

c) Bashkitë Lushnjë, Kuçovë, Vlorë, Patos, Kolonjë janë në përqindjen 33-36 %.


d) Vihet re se bashki të mëdha si Tirana, Elbasani, Durrësi, janë shumë poshtë kufirit ligjor për plotësim;

e) 26 bashki kanë zero përqindje të plotësimit të detyrimit ligjor.

f) Në bashkitë e drejtuara nga kryetare bashkie grua, kryeson Kurbini me 3 administratore (100%), ndjekur nga Libohova dhe Dimali me 50%, Lushnja dhe Patosi me 33-36% dhe tjerat nën kufirin ligjor prej 30%.

46 Bashki, ose 75% **nuk plotësojnë detyrimin ligjor** prej 30% gra në pozicionin e administratorëve

6. RESPEKTIMI I DETYRIMIT LIGJOR TË PËRFAQËSIMIT GJINOR ME TË PAKTËN 30% NË PUNËSIMIN NË ADMINISTRATËN BASHKIAKE.



- a) 95% e bashkive raportojnë që sigurojnë respektimin në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit gjatë emërimit të punonjësve në bashki;
- b) Vetëm 3 Bashki (Patos, Kavajë, Peqin), ose 5% nuk plotësojnë detyrimin ligjor prej 30% gra të punësuar në administratën bashkiake.
- c) Kryesojnë bashkitë Mirditë dhe Tiranë me 63 % gra të punësuar në administratën bashkiake.
- d) Në bashkitë e drejtuara nga kryetare bashkie, përveç Bashkisë Patos (22%), të gjitha bashkitë e tjera e plotësojnë dhe e tejkalojnë përqindjen ligjore prej 30%. Shkodër 50%, Dimal 54%, Libohovë 31%, Përmet 43%, Durrës 39%, Delvinë 44%, Kurbin 41%, Lushnjë dhe Roskovec 30%.



Vetëm 3 Bashki (Patos, Kavajë, Peqin), ose 5% nuk plotësojnë detyrimin ligjor prej 30% gra të punësuar në administratën bashkiake.

100 % e bashkive raportojnë që sigurojnë respektimin në mënyrë të njëjtë për secilën gjini të procedurave dhe kriterëve të konkurrimit gjatë emërimit të punonjësve në bashki



7. RESPEKTIMI I DETYRIMIT LIGJOR TË PËRFAQËSIMIT GJINOR ME TË PAKTËN 30% 30% NË ZGJEDHJEN E ORGANEVE DREJTUESE TË BASHKISË.

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

SEKRETAR/E I/E PËRGJITHSHËM

- a) Nga 61 bashki, vetëm 35 bashki kanë pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm;
- b) Nga 35 bashki që kanë pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, vetëm në 9 bashki këtë pozicion e kanë gra (Përmet, Elbasan, Dibër, Berat, Dimal, Kuçovë, Poliçan Roskovec, Pogradec);
- c) Vihet re se bashki të mëdha si Tirana, Fieri, Durrësi, Shkodra, nuk e kanë pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm.
- d) Në bashkitë e drejtuara nga kryetare bashkie grua, vetëm 6 bashki e kanë si pozicion Përmet, Dimal, Kurbin, Lushnjë, Patos dhe Roskovec. Vetëm 3 nga këto bashki e kanë sekretarin e përgjithshëm grua (Përmet, Dimal, Roskovec).

DREJTOR/E DEPARTAMENTI

- a) Vetëm 8 nga 61 bashki kanë pozicion Drejtor Departamenti (Pukë, Tepelenë, Elbasan, Peqin, Tiranë, Rrogozhinë, Fier, Korçë);
- b) Nga 8 bashki që kanë pozicionin Drejtor Departamenti, vetëm 5 bashki plotësojnë detyrimin për 30% gra (Pukë, Tepelenë, Tiranë, Fier, Korçë).

DREJTOR DREJTORIE

- a) 55 bashki nga 61 bashki kanë pozicionin Drejtor Drejtorie;
- b) Nga 55 bashki që kanë pozicionin Drejtor Drejtorie, 39 bashki e plotësojnë detyrimin për 30 % gra. Kryesojnë Bashkia Mirditë me 80% raporti i grave në lidhje me totalin e pozicioneve Drejtor drejtorie. Bashkitë Bulqizë, Mallakastër, Rrogozhinë, Konispol, Tropojë, Divjakë, Kukës, Peqin, Dibër, Gramsh janë poshtë minimumit ligjor prej 30%. Bashkitë Fushë-Arrëz, Belsh, Mat, Klos, Himarë, Devoll nuk kanë asnjë grua në pozicionin Drejtor Drejtorie.
- c) Në bashkitë e drejtuara nga kryetare bashkie, raporti i grave në lidhje me totalin e numrit të drejtorëve të drejtorisë është mbi minimumin ligjor prej 30%. (varion nga 38-50%).


PËRGJEGJËS SEKTORI

- a) 59 bashki nga 61 bashki kanë pozicionin Përgjegjës Sektori;
- b) Nga 59 bashki që kanë pozicionin Përgjegjës Sektori, 43 bashki plotësojnë detyrimin për 30% gra. Kryeson Bashkia Poliçan me 100% të plotësisht të detyrimit ligjor.
- c) Bashkitë Bulqizë, Mat, Kukës, Gjirokastrë, Mallakastër, Dibër, Konispol, Has, Belsh, Krujë, Finiq, Kolonjë, Delvinë, Sarandë, Pustec, Vorë nuk respektojnë përqindjen ligjore prej 30 %..
- d) Në bashkitë e drejtuara nga kryetare bashkie, kjo përqindje varion 33-71%, përveç Bashkisë Delvinë me 9%.


DREJTOR NDËRMARRJEJE/AGJENSIE/BORDE

- a) 36 nga 61 bashki kanë pozicionin drejtor Ndërmarrjeje/Agjencie;
- b) 16 bashki e kanë përqindjen 0% e raportit të grave mbi totalin e numrit të drejtorëve të ndërmarrjeve/agjencive. Bashkia Kurbin këtë përqindje e ka 25%.
- c) 19 bashki nga 36 bashkitë që e kanë pozicionin drejtor Ndërmarrjeje/ Agjencie plotësojnë detyrimin për 30 % gra. Kryeson bashkia Mat me 100%. 17 bashki janë nën përqindjen ligjore të kërkuar;
- d) 51 bashki kanë krijuar borde me pjesëmarrje, nga të cilat vetëm 31 bashki plotësojnë detyrimin për 30 % gra në këto borde. Kryeson bashkia Kukës.
- e) Në bashkitë e drejtuara nga gra, bashkitë Durrës, Lushnjë dhe Roskovec e tejkalojnë përqindjen ligjore prej 30%, në raportin e grave mbi totalin për drejtor ndërmarrjesh e agjencish. Bashkia Kurbin 25%, Bashkitë Dimal dhe Patos 0%, ndërsa për të tjerat nuk ka të dhëna.

POZICIONI I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM



POZICIONE DREJTUESE NË ADMINISTRATËN BASHKIAKE



1	Pozicioni Sekretar i përgjithshëm	9 nga 34 bashki që e kanë këtë pozicion, janë gra
2	Pozicioni Drejtor departamenti	3 nga 9 bashki që e kanë këtë pozicion, nën 30%
3	Pozicioni Drejtor drejtorie	16 nga 55 bashki që e kanë këtë pozicion, nën 30%
4	Pozicioni Përgjegjës sektori	16 nga 59 bashki që e kanë këtë pozicion, nën 30%
5	Pozicioni Drejtor ndërmarrjeje/agjensie	17 nga 36 bashki që e kanë këtë pozicion, nën 30%
6	Borde me pjesëmarrje 30% gra	5 nga 38 bashki që kanë nën 30% gra

8. MASA KONKRETE PËR KRIJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURIMEVE FINANCIARE VENDORE QË TË PËRSHPEJTOJË E REALIZOJË BARAZINË GJINORE.


Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

Nga 61 bashki, 45 bashki kanë marrë masa konkrete për krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore që të përshpejtojë e realizojë barazinë gjinore.


Masat konkrete janë:


- 33 bashki Buxhet gjinor;
- 28 bashki, nisma gjinore për fuqizimin ekonomik;
- 16 bashki, grante për biznese të drejtuara nga gra kryefamiljare;
- 28 bashki, promovim të grave e vajzave për punër artizanale;
- 13 bashki, proces pjesëmarrës me 50% gra e vajza.

BASHKIA MERR MASA KONKRETE PËR KRIJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURIMEVE FINANCIARE VENDORE QË TË PËRSHPEJTOJË E REALIZOJË BARAZINË GJINORE.



MASA KONKRETE TË BASHKIVE PËR KRIJIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURIMEVE FINANCIARE VENDORE.






9. OBJEKTIVAT GJINORE NË PROGRAMET BUXHETORE.

Për Objektivat Gjinorë, gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

- a) 23 bashki nuk kanë asnjë objektiv gjinor në programet e buxhetuara;
- b) 13 bashki kanë 3-20% të programeve me objektiva gjinorë;
- c) 16 bashki kanë 20-50 të programeve me objektiva gjinorë;
- d) 9 bashki kanë mbi 50% të programeve me objektiva gjinorë;
- e) 15 bashki ose 25% përgjigjen që e dinë sa është raporti i shpenzimeve për politikat gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme dhe e raportojnë atë;
- f) Në grupin e bashkive që drejtohen nga gra, kryeson Bashkia Delvinë me 63% raporti i totalit të programeve të buxhetuara me objektiva gjinore në raport me totalin e programeve të buxhetuara. Pasohet nga bashkitë Lushnjë, Patos, Roskovec 42-45%.

NUMRI I BASHKIVE SIPAS PROGRAMEVE ME OBJEKTIVA GJINORE



- **15 bashki, ose 25%** përgjigjen që e dinë sa është raporti i shpenzimeve për politikat gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme dhe e raportojnë atë.
- **24 bashki, ose 39%** përgjigjen që kanë vendosur tregues gjinorë, brenda sistemit të treguesve, për matjen e performancës në administrimin e shërbimeve publike.
- **61 bashki, 100%** përgjigjen që nuk ka një strukturë specifike, e cila monitoron treguesit gjinorë gjatë monitorimit të performancës së shërbimit.


10. TREGUESIT GJINORË DHE NGRITJA E NJËSISË SË PERFORMANCËS

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

a) Nga 61 bashki, vetëm 24 bashki kanë hartuar dhe vendosur tregues gjinorë brenda sistemit të treguesve për matjen e performancës në administrimin e shërbimeve publike. Në bashkitë e drejtuara nga gra, vetëm bashkitë Dimal, Delvinë, Kurbin, Lushnjë, Patos, Roskovec, raportojnë se kanë hartuar dhe vendosur tregues të tillë.

b) Asnjë bashki nuk ka ngritur Njësine e Performancës. Përgjigjet janë të ndryshme sipas bashkive, ku raportohet se këtë monitorim e kryejnë sektori i burimeve njerëzore apo dhe sektori i barazisë gjinore.

TREGUESIT GJINORË




11. GRANTET PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

a) Nga 61 bashki, vetëm 10 bashki japin grante për bujqësinë e zhvillimin rural Gjirokastër, Elbasan, Tirana, Fier, Lushnjë (G), Patos (G), Roskovec (G), Mallakastër, Divjakë, Maliq);

b) Nga 10 bashki që japin grante për bujqësinë, vetëm 3 prej tyre (Tirana, Fier, Maliq). plotësojnë detyrimin ligjor që të paktën 30% të përfitohen nga gratë. Kryeson Tirana me 75% të grave përfituese.


PËRQINDJA E GRAVE PËRFITUESE TË SKEMAVE VENDORE TË GRANTEVE NË TRE VITET E FUNDIT




12. NËPUNËSI VENDOR PËR BARAZINË GJINORE, KOORDINATORI DHF DHE MKR

Gjetjet e Anketimit mbi nëpunësin vendor për çështjet e barazisë gjinore, koordinatorin për rastet e dhunës familjare dhe Mekanizmin e koordinuar të Referimit për rastet e dhunës familjare, janë si më poshtë:

- a) Nga 61 bashki, vetëm 4 bashki nuk kanë një punonjës për barazinë gjinore (Vau Dejës, Dropull, Durrës (G), Konispol);
- b) Nga 57 bashki me punonjës barazie gjinore, në 35 bashki ky punonjës nuk punon me kohë të plotë;
- c) Nga 61 bashki, 5 bashki nuk kanë coordinator për dhunën familjare (Librazhd, Skrapar, Delvinë, Dropull, Tropojë);
- d) Nga 56 bashki që kanë coordinator për dhunën familjare, 37 bashki nuk e kanë këtë punonjës me kohë të plotë për dhunën familjare;
- e) Të gjitha bashkitë e kanë të ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës në familje.
- f) 57 bashki deklarojnë që kanë bashkëpunim me njësi të tjera të qeverisjes vendore për të garantuar mbrojtjen dhe shërbimet e nevojshme për rastet e dhunës në familje.
- g) 35 bashki deklarojnë që kanë patur raste kur koordinatori vendor për dhunën ka kërkuar urdhrin e mbrojtjes.



KOORDINATORI VENDOR PËR DHUNËN NË FAMILJE



5 Bashki nuk kanë koordinatori për DhF

Në 37 nga 56 Bashki koordinatori për dhunën në familje nuk është punonjës i dedikuar për dhunën në familje

MEKANIZMI I KOORDINUAR TË REFERIMIT PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE

Bashki që kanë Mekanizmin e Koordinuar



BASHKËPUNIMI ME NJËSITË VENDORE TË TJERA PËR DHUNËN NË FAMILJE



Bashki që kanë bashkëpunim me njësi të tjera të qeverisjes vendore për të garantuar mbrojtjen dhe shërbimet e nevojshme për rastet e dhunës në familje

Bashki që nuk kanë bashkëpunim me njësi të tjera të qeverisjes vendore për të garantuar mbrojtjen dhe shërbimet e nevojshme për rastet e dhunës në familje

13. PROMOVIMI I BARAZISË DHE PARANDALIMI I DISKRIMINIMIT

Gjetjet e Anketimit janë:

Nga 61 bashki, 58 bashki raportojnë se kanë marrë masa konkrete për të promovuar barazinë gjinore dhe parandaluar diskriminimin me bazë gjinore.


Për masat konkrete, gjendja paraqitet si më poshtë:

- a) 55 bashki kanë ndërmarrë fushata ndërgjegjësuese;
- b) 43 bashki kanë zhvilluar trajnime/workshope;
- c) 33 bashki kanë hartuar plane/strategji në nivel lokal;
- d) 43 bashki kanë realizuar marrëveshje bashkëpunimi.


Përsa i përket Diskriminimit Gjinor, nga 61 bashki, vetëm 3 bashki (Kuçovë, Delvinë, Korçë) raportojnë se kanë identifikuar raste diskriminimi për shkak të gjinisë në bashkinë e tyre.

Ndërsa për masat konkrete, gjendja paraqitet si më poshtë:

- a) 4 bashki kanë marrë masa mbi informimin mbi mekanizmat ligjorë në territorin e bashkisë (Memaliaj, Kuçovë, Has);
- b) 5 bashki kanë referuar tek komisioneri kundër diskriminimit (Memaliaj, Kuçovë, Has, Delvinë);
- c) 1 bashki (Has) ka referuar tek Avokati i Popullit;
- d) 3 bashki kanë marrë masa për informim për veprimet ligjore që duhet të ndjekë rasti.



BASHKI QË KANË MARRË MASA PËR PROMOVIMIN E BARAZISË GJINORE DHE PARANDALIMIN E DISKRIMINIMIT ME BAZË GJINORE



DISKRIMINIMI GJINOR



BASHKI QË KANË MARRË MASA NDAJ DISKRIMINIMIT GJINOR




14. MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I STATISTIKAVE VENDORE, TË NDARA SIPAS GJINISË

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

- a) 16 bashki nuk mbledhin asnjë statistikë gjinore (Peqin, Dibër, Skrapar, Kavajë, Vau Dejës, Malësi e madhe, Pukë, Dropull, Libohovë, Memaliaj, Prrenjas, Bulqizë, Dimal, Kuçovë, Tropojë, Fier);
- b) Vetëm 3 bashki mbledhin dhe përpunojnë statistika vendore të ndara sipas gjinisë në të gjitha 9 funksionet (Cërrik, Berat, Lezhë);
- c) 5 bashki mbledhin statistika gjinore për 1 funksion (Elbasan, Belsh, Mat, Vlorë, Kolonjë);
- d) 4 bashki mbledhin statistika gjinore për 2 funksione (Durrës, Delvinë, Himarë, Tiranë);
- e) 8 bashki mbledhin statistika gjinore për 3 funksione (Shkodër, Librazhd, Krujë, Klos, Finiq, Rrogozhinë, Kamzë, Pustec);
- f) 7 bashki mbledhin statistika gjinore për 4 funksione (Fushë-Arrëz, Tepelenë, Poliçan, Sarandë, Mirditë, Lushnjë, Korçë);
- g) 8 bashki mbledhin statistika gjinore për 5 funksione (Këlcyrë, Shijak, Selenicë, Konispol, Patos, Roskovec, Mallakastër, Divjakë);
- h) 6 bashki mbledhin statistika gjinore për 6 funksione (Gramsh, Kurbin, Has, Maliq, Pogradec, Devoll);
- i) 2 bashki mbledhin statistika gjinore për 7 funksione (Gjirokastrë, Përmet);
- j) 1 bashki mbledhin statistika gjinore për 8 funksione (Kukës).
- k) Në bashkitë e drejtuara nga gra, kryeson bashkia Përmet, që mbledh statistika për 7 funksione me të dhëna gjinore, ndjekur nga bashkia Kurbin me 6 të tilla.

NUMRI I BASHKIVE SIPAS FUNKSIONEVE KU MBLEDHIN TË DHËNA GJINORE




15. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

- a) Nga 61 bashki, 42 bashki kanë bazë të dhënash për organizatat lokale, kombëtare e ndërkombëtare që operojnë në fushën e barazisë gjinore;
- b) Nga 61 bashki, 39 bashki bashkëpunojnë me organizata jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore.
- c) Në grupin e bashkive të drejtuara nga gra, të gjitha bashkitë përgjigjen pozitivisht.



BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE




16. STREHIMI SOCIAL


Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

- Nga 61 bashki gjithsej, vetëm 40 bashki kanë publikuar në faqen zyrtare të internetit apo afishuar në vende të tjera publike, informacion të plotë e të kuptueshëm për programet sociale të strehimit për gratë kryefamiljare, vajzat nëna dhe viktimat e dhunës në familje;
- Asnjë bashki nuk plotëson të gjitha kriteret e ligjit për strehimin social për kategoritë e strehimit dhe kategoritë e përfitueseve gra/vajza;
- Nga 61 bashki gjithsej, 38 bashki kanë planifikuar fonde për strehimin social.
- Në grupin e bashkive të drejtuara nga gra, të gjitha bashkitë kanë të planifikuara fonde të tilla.

-  40 Bashki kanë publikuar në faqen zyrtare të internetit apo afishuar në vende të tjera publike, informacion të plotë e të kuptueshëm për programet sociale të strehimit për gratë kryefamiljare, vajzat nëna dhe viktimat e dhunës në familje.
-  21 Bashki nuk kanë publikuar në faqen zyrtare të internetit apo afishuar në vende të tjera publike, informacion të plotë e të kuptueshëm për programet sociale të strehimit për gratë kryefamiljare, vajzat nëna dhe viktimat e dhunës në familje.



- 38 Bashki kanë planifikuar fonde për strehimin social.
- 23 Bashki nuk kanë planifikuar fonde për strehimin social.




17. KUJDESI PËR PUNËSIMIN E VAJZAVE NËNA DHE SISTEMIN E FËMIJËVE TË TYRE NË SISTEMIN PARASHKOLLOR PUBLIK.

Gjetjet e Anketimit shfaqen si më poshtë:

- Nga 61 bashki gjithsej, vetëm 13 bashki ofrojnë kujdes me masa konkrete për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.
- Në fushën e punësimit, ka praktika të bashkëpunimit me bizneset private.
- Sistemimi i fëmijëve në sistemin parashkollor publik bëhet me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe është praktikë për 11 Bashki.

PUNËSIMI I VAJZAVE DHE NËNAVE DHE SISTEMIMI I FËMIJËVE NË KOPSHTE

- Vetëm 48 Bashki nuk ofrojnë kujdes me masa konkrete për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.
- Vetëm 13 Bashki ofrojnë kujdes me masa konkrete për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.




18. SHËRBIME SOCIALE PËR GRATË, GRATË KRYEFAMILJARE, GRATË E DHUNUARA, VIKTIMA TË TRAFIKUT, NËNA APO PRINDËR ME SHUMË FËMIJË.

Gjetjet e Anketimit janë si më poshtë:

Nga 61 bashki gjithsej, 51 bashki kanë krijuar apo administrojnë shërbime sociale për gratë, gratë kryefamiljare, gra të dhunuar, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit. Nuk kanë bashkitë fushë-Arrëz, Dropull, Libohovë, Skrapar, Finiq, Himarë, Lezhë, kurbin, Tropojë). Në grupin e bashkive të drejtuara nga gratë, të gjitha bashkitë raportojnë pozitivisht.

SHËRBIME SOCIALE PËR GRATË




19. STREHËZA

Nga 61 bashki gjithsej, vetëm 14 bashki kanë ndërtuar strehëza si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prindër i vetëm apo viktime të dhunës familjare (Shkodër, Gjirokastër, Përmet, Tepelenë, Krujë, Dibër, Berat, Dimal, Finiq, Tirana, Kukës, Korçë, Maliq, Pogradec).

Në grupin e bashkive të drejtuara nga gra, raportojnë për strehëza vetëm bashkitë Shkodër, Përmet, Dimal.


STREHËZA SI SHËRBIM I KUJDESIT SHOQËROR PËR GRATË, VAJZAT SHTATZËNA, PRIND I VETËM APO VIKTIMA TË DHUNËS FAMILJARE



20. NDËRMARRJE SOCIALE PËR GRATË

Gjetjet e Anketimit:

Nga 61 bashki gjithsej, vetëm 23 bashki raportojnë që bashkia mbështet politika mbi ndërmarrje sociale për gratë, gratë në zonat rurale, vajzat viktime të dhunës familjare (Vau Dejës, Malësi e Madhe, Gjirokastër, Përmet, Memaliaj, Krujë, Dibër, Kuçovë, Poliçan, Selenicë, Finiq, Konispoli, Rogozhinë, Kavajë, Vorë, Kamzë, Lushnjë, Patos, Roskovec, Mallakastër, Divjakë, Korçë, Devoll). Në grupin e bashkive të drejtuara nga gra, kësaj pyetjeje i përgjigjen pozitivisht bashkitë Përmet, Lushnjë, Patos, Roskovec.



IV. KONKLUZIONE

Shqipëria ka bërë hapa domethënës për sa i përket përpjekjeve për të integruar në mënyrë integrale konceptin dhe mekanizmat ligjorë për të garantuar respektimin e barazisë gjinore në qeverisjen vendore. Për sa i përket legjislacionit, duket se është krijuar një sistem gjithëpërfshirës për të realizuar barazinë gjinore për sa i përket pjesëmarrjes në nivel kuantitativ, por edhe për sa i përket integritit gjinor në politikat vendore.

Në vijim të rezultateve të Barometrit të Barazisë Gjinore, sipas pyetësorit përkatës të plotësuar nga të 61 Bashkitë e Shqipërisë, rezulton se përgjithësisht ka një respektim të detyrimeve ligjore kuantitative të përcaktuara nga Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri, veçanërisht për sa i përket pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrje, por ende mbeten të papërmbyshura parashikime ligjore në këtë aspekt. Një nga gjetjet e Barometrit, është pikërisht se 80% e bashkive (49 bashki nga 61) nuk e plotesojnë detyrimin ligjor për të patur 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar (në rastin konkret gra) në pozicionin “Administrator/e i/e njësisë administrative”.

Duket gjithashtu se përmbushen në pjesën më të madhe të Bashkive parashikimet e Ligjit Antidiskriminim dhe Ligjit për masat ndaj dhunës familjare, si dhe respektohen detyrimet e përcaktuara nga Ligji për Vetqeverisjen Vendore, por zbatohen shumë më pak parashikimet ligjore të përcaktuara nga Ligji për Financat vendore. Por edhe për këto fusha ka mangësi për sa i përket zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve ligjore. Në rastin e Ligjit për Dhunën në Familje, vetëm 23 % e bashkive (14 Bashki) kanë strehëza si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktimat e dhunës familjare.

Në lidhje me integrimin gjinor në politika, indikatorët gjinore dhe disagregimin gjinor në të dhënat dhe statistikat e përmbledhura nga Bashkitë, vërehet se:

- 1.** 3% e bashkive (45 Bashki nga 61) nuk e dinë sa është raporti i shpenzimeve për politikën gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme dhe e raportojnë atë
- 2.** 57% e bashkive (35 Bashki nga 61) nuk kanë vendosur tregues gjinorë, brenda sistemit të treguesve, për matjen e performancës në administrimin e shërbimeve publike.
- 3.** 100% e bashkive (61) përgjigjen që nuk kanë një strukturë specifike, e cila monitoron treguesit gjinorë gjatë monitorimit të performancës së shërbimit.
- 4.** 17 Bashki nuk mbledhin asnjë statistikë gjinore. Vetëm 3 Bashki mbledhin dhe përpunojnë statistika vendore të ndara sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Në lidhje me fuqizimin ekonomik dhe integrimin gjinor edhe në politikën mbështetëse për gratë dhe vajzat vërrehet se nga 10 Bashki që japin grante për bujqësinë, vetëm 3 prej tyre plotësojnë detyrimin ligjor, që të paktën 30% të përfitohen nga gjinia më pak e përfaqësuar (në rastin konkret gratë dhe vajzat).

Një nga mangësitë kryesore të vërejtura në nivel kombëtar, ka lidhje me zbatimin e ligjeve për strehimin social, kujdesin shoqëror dhe ndërmarrjet sociale, për të cilat pjesa më e madhe e Bashkive rezulton të mos i ketë përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në këtë pjesë. Sipas rezultateve të Pyetësorit asnjë prej të 61 Bashkive nuk i plotëson të gjitha kriteret e ligjit për strehimin social për kategoritë e strehimit dhe kategoritë e përfitueseve gra/vajza.

Në një konkluzion të përgjithshëm nga Barometri i Barazisë Gjinore, rezulton se ka një përpjekje për zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e Bashkive, e cila në disa raste mbetet në nivel të zbatimit formal e në disa raste zbatohet me rigorozitet. Në këtë aspekt vërehet se, pjesa e detyrimeve të cilat kanë më shumë rezistencë për t'u zbatuar nga ana e Bashkive, janë ato për të cilat duhet ekspertizë e specializuar dhe buxhet i dedikuar për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

V. REKOMANDIME

Në vijim të konkluzioneve të mësipërme rezulton se në të 61 Bashkitë e Shqipërisë ka një zbatim formal të pjesës më të madhe të detyrimeve ligjore përsa i përket garantimit të barazisë gjinore, por ka ende shumë hapa që duhet të ndërmerren përsa i përket garantimit real dhe përmbajtësor të barazisë gjinore, vecanërisht në pjesën e buxhetimit. Në këtë kuadër, disa nga rekomandimet kryesore nga ky raport do të ishin:

1 Ripërsëritja periodike e pyetësorit në nivel lokal në të 61 Bashkitë për të kuptuar ecurinë e proceseve të zbatimit të parashikimeve ligjore në lidhje me barazinë gjinore si edhe më fushat ku duhet më tepër investim përsa i përket zbatueshmërisë së këtyre kërkesave ligjore

2 Nxitja e buxhetimit gjinor dhe investimit të metejshëm në struktura që ofrojnë shërbime të parashikuara me ligj, si koordinatori/ja vendor për dhunën, koordinatori/ja për barazinë gjinore, etj. Fuqizimi i këtyre strukturave rrjedhimisht do të sjellë edhe përmirësimin e shërbimeve dhe përmbushjen e mëtejshme të parashikimeve ligjore për barazinë gjinore në nivel vendor.

3 Përforcimi i bashkëpunimit, me pushtetin qendror për të drejtuar në mënyrën e duhur investimet dhe politikat për barazinë gjinore në funksion të zbatimit optimal të tyre.

4 Investimi në ekspertizën e nevojshme për të garantuar zbatimin e parashikimeve ligjore përsa i përket përcaktimit të treguesve gjinorë dhe matjes së performancës në nivel vendor.

5 Vendosja në çdo program të buxhetuar nga bashkitë, të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.

6 Garantimi i transparencës dhe aksesit në informacion në lidhje me 4 kategoritë e programit social të strehimit.

7 Rritja e bashkëpunimit të administratës në secilën Bashki me Komisionin e Barazisë Gjinore pranë Këshillit Bashkiak dhe Aleancën e Grave Këshilltare Bashkiake në Bashkitë për të nxitur zbatimin e mëtejshëm të 25 parashikimeve ligjore për barazinë gjinore në nivel vendor.